

Partizani/ Te huajt, zhgenjimi i merkatos se kuqe

nga AlbaniaSoccer
E diel, 10 Nentor 2013 20:38



Patrik Bordon, Vladimir Buac dhe Sodje jane tre sulmuesit qe kane zhgenjyer Partizanin. Drejtuesit dhe treneri Hasan Lika besuan shume tek aftesite e ketyre lojtareve qe nuk kane treguar thujtase asgje ne fazen e pare te kampionatit. Te tre sulmuesit e huaj kane patur shancet e tyre per te luajtur ne formacion por nuk kane treguar asnje vlere. Ndryshe beri Malo qe realizoi tre gola te rëndesishem, Dushku dhe Mitraj gjithashtu kane bere me mire se te huajt edhe pse paguhen shume me pak se ata. Ne janar, Partizani po mendon ti largoje e te afroje futbolliste te tjere me cilesore per sulmin.